



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:276755
Datë: 19.10.2023
Numri i dokumentit: 04806395

C.nr.1899/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala dhe bashkëpunëtoren profesionale Ardiana Nikollbibaj Thaqi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit R.TH., nga Gjakova, të cilin me autorizim e përfaqësojnë të autorizuarit Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, jashtë seance me datën 19 tetor 2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Paditësit R.TH., nga Gjakova i KTHEHET në plotësim padia e parashtruar me datë 15.12.2022, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë me provat e caktuara.

II. Do të konsiderohet se është tërhequr padia po që së nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia.

A r s y e t i m

Paditësi R.TH., nga Gjakova, pranë kësaj gjykate me datë 15.12.2022, përmes të autorizuarve të tij Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë gjeti se e njëjta nuk është e pajisur me provat me të cilat vërtetohen pretendimet e paditësit, përkatësisht nuk ka prova me të cilën vërtetohet lartësia e pagës bazë të tij për periudhën e përfshirë në padi, pra nuk ka prova se sa ka qenë paga bazë e tij në vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Numri i lëndës: 2022:276755
Datë: 19.10.2023
Numri i dokumentit: 04806395

Meqenëse gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë, në kuptim të nenit 99 par.2 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.1899/22, me datë 19 tetor 2023

Gj y q t a r j a
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.